

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit
Bachelor në “Sisteme të Informacionit”
Universiteti i New York-ut në Tiranë

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Elinda Kajo Meçe



Olimpjon Shurdi



Nëntor 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në "Sisteme të Informacionit"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Fakulteti /Departamenti që e ofron	Fakulteti i Informatikës/ Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMAS nr. 268, datë 28.06.2013
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Akreditohet për herë të parë
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Sisteme të Informacionit"
6	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
13	Diplomë e përbashkët/Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
15	Aktivizimi i programit të studimit	2013-2014
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2016
17	Numri i studentëve	6 studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim;




HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit

Programi i Studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit, në gjuhën shqipe, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, është licencuar me Urdhër të Ministrit Nr. 268, datë 28.06.2013 “Për hapjen e programeve të reja të të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë”, “Administrim Biznesi”, “Sisteme të Informacionit”, të Universitetit privat “Universiteti i New York-ut në Tiranë [dok “ Urdhër i MASH për Licensimin e Programeve Shqip 2013”].

Në vitin 2013 Universiteti i New York-ut ofronte programin e studimit Bachelor në “Information Systems” në gjuhën angleze dhe me organizim të programit sipas modelit amerikan, me kohëzgjatje normale 4 vjet. Hapja e programit të studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit, në gjuhën shqipe dhe me kohëzgjatje normale 3 vjet u bë për të mundësuar studime të ngjashme për studentët me njohuri të kufizuara të gjuhës angleze dhe të dilnin në tregun e punës në një kohë më të shkurtër.

Plani mësimor është ndjekur pothuajse sipas kurrikulës së licencuar të programit të studimit [dok “Tabela e Organizimit të Programit – Sisteme të Informacionit”].

Brezi i parë dhe i vetëm i studentëve në këtë program studimi është regjistruar në vitin akademik 2013-2014 dhe tashmë një pjesë e tyre i kanë plotësuar kriteret e programit për diplomim.

Në përfundim të vitit akademik 2015-2016, 3 (tre) studentë kanë fituar të gjitha kredite dhe janë diplomuar, nuk është lëshuar diploma përkatëse për shkak të vonesës nga ana e institucionit për akreditimin e programit të studimit si detyrim ligjor.

Forma e diplomës nuk është regjistruar në ministrinë përkatëse.

Ky raport vlerëson programin e studimit për brezin e studentëve të rregjistruar në vitin akademik 2013-2014.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Prof.As. Elinda Kajo Meçe
- Prof.As. Olimpjon Shurdi

Koordinatorë teknikë të kësaj procedure kanë qenë R. Qatipi dhe E. Xhako (specialistë në ASCAL).

Më datë 02.12.2018 Universiteti i New York-ut në Tiranë është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për këtë program studimi, nëpërmjet sistemit AMS. Me shkresë Nr. 39/18 Prot., datë 27.11.2018 “Dërgohet Draft Raporti i vlerësimit të jashtëm”, Draft RVJ është dërguar zyrtarisht.

Universiteti i New York-ut në Tiranë ka sjellë përgjigje me shkresë Nr. 364, datë 04.12.2018 “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit “Bsc. Sisteme të Informacionit”, duke u shprehur që “nuk ka asnjë koment lidhur me Draft RVJ”.

Pas përgjigjes, Raporti mori formën e tij përfundimtare.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Qëllimi i Programit të Studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit [sipas RVB faqe 6] është i projektuar për të pajisur studentët me njohuri dhe aftësi që i ndihmojnë të diplomuarit drejt një profili profesional, si p.sh. analist i sistemeve të informacionit, specialist databazash për sistemet informative, zhvillues sistemesh apo për të vazhduar studime të mëtejshme pasuniversitare. Programi synon të kombinojë teorinë mbi shkencat kompjuterike dhe informatike në tërësi dhe praktikën në lidhje me analizën, projektimin dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit, duke i nderthurur me njohuri të shkencave të menaxhimit dhe aspekte të proceseve vendimarrëse.

Objektivat e Programit të Studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit [sipas RVB faqe 6,7] janë që në përfundim të studimeve një student të fitoj kompetencat si më poshtë:

- Të kuptojë procesin e analizimit dhe projektimit të sistemeve të informacionit të bazuar në zgjidhje software
- Të bëhet kompetent në menaxhimin e sistemeve të informacionit dhe në mirëmbajtjen e tyre me synimin përfundimtar të optimizimit të procesit të vendimarrjes.
- Të bëhet kompetent në implementimin me sukses të zgjidhjeve praktike që kanë të bëjnë jo vetëm me sistemet informative bazuar në software, por edhe me ndërtim dhe manipulim databazash, ndërtim dhe menaxhim rrjetesh për ngritjen e infrastrukturës bazë të një sistemi informativ.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi i studimit Bsc në Sisteme të Informacionit është në përputhje me qëllimet dhe misionin e UNYT, të përcaktuar në Statutin e Universitetit.[dok “ Statuti i Universitetit”]. Objektivat e programit të studimit Bsc në “Sisteme të Informacionit” të paraqitura në pjesën përshkruese më sipër, përcaktojnë qartë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. [dok “Rregullore e Programeve Bachelor ne Gjuhen Shqipe”]. Programi Bachelor në Sisteme të Informacionit është hapur bazuar në studimin e tregut të punës të zhvilluar nga UNYT në maj 2013 [dok “Studimi i Tregut per Programet Shqip – 2013”]. UNYT ka një strategji të përgjithshme të studimit të tregut në nivel institucional [dok “UNYT Market Research Strategy”]. Programi Bachelor në Sisteme të Informacionit është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, duke plotësuar
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	

	nevojën me profesionistë në sektorin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>UNYT ofron programe studimi që janë në përputhje me strategjinë e vet të zhvillimit , të përcaktuar në Planin Strategjik. Programi Bachelor në Sisteme të Informacionit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional.</p> <p>[dok “ Plani Strategjik i UNYT 2012-2017”]</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit synon të krijojë specialistë të sistemeve të informacionit me aftësi në programim, në baza të të dhënave, Inxhinierinë e Softit, kontabilitetin.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi I studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit është i bazuar në një studim të tregut të punës, i cili është kryer paraprakisht nga UNYT në maj 2013 [dok “Studimi i Tregut per Programet Shqip – 2013”].</p> <p>Studimi i tregut arsyeton nevojën për profesionistë në sistemet e informacionit , mundësitë e punësimit në tregun vendas dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p>Programi i studimit ka vetëm një brez studentësh te rregjistruar 2013-2014, (8 studente te rregjistruar) në këto kushte nevojitet një rivlerësim i programit të studimit për vazhdimin e mëtejshem të tij.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Bazuar në qëllimin dhe objektivat e paraqitura më sipër, nuk ka pika ku ky program bie ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit nëpërmjet edukimit të specialistëve të fushes, ndihmon në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.</p>
Konkluzione të GVJ:	
<p>Programi i studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit është në përputhje me qëllimet, misionin dhe strategjinë e zhvillimit të UNYT. Objektivat e programit të studimit përcaktojnë qartë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit është i bazuar në një studim të tregut të punës, i cili është kryer paraprakisht nga UNYT në maj 2013. Programi i studimit ka vetëm një brez, prej 8 studentësh te rregjistruar 2013-2014, në këto kushte nevojitet një rivlerësim i programit të studimit nga Universiteti për vazhdimin e mëtejshem të tij.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti i UNYT është i përbërë nga 3 njësi kryesore Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, dhe Fakulteti i Informatikës [dok “ urdhëri MASR, Nr. 288, datë 22.05.2017”]. Programi i studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike i cili është pjesë e Fakultetit të Informatikës. Fakulteti i Informatikës, i krijuar në vitin 2017, dhe përbëhet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike [dok“ Organigrama e universitetit sipas statutit të vitit 2017”].

Fakulteti i Informatikës në vitin akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 21 personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 me kontratë (PAK) [Tabela 1, 2].

Fakulteti i Informatikës dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike organizojnë dhe drejtojnë mësimdhënien në programin e studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit. Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka shtatë anëtarë, nga të cilët 1 Prof.As, 2 janë me titull Doktor dhe një në proces Doktor, 3 janë me titullin Master. Dy departamentet, Shkenca Kompjuterike dhe Informatika e Biznesit, ofrojnë programe studimi Bachelor dhe Master.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike koordinon mësimdhënien me njësitë e tjera, në veçanti me departamentet e Fakultetit të Informatikës përmes shkëmbimit të stafit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës. Personeli akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personeli akademik i ftuar. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në Kontratën e Punës.

Gjatë vizitës në institucion, në takim me drejtuesit e fakultetit dhe departamenti u deklarua se, dy prej stafit akademik me tituj, Prof. Dr dhe Dr. sapo kishin dhënë dorëheqjen, në këto kushte institucioni do të marrë masa për nisjen e procedurave të punësimit për vendet e krijuar bosh. Largimi i tyre reduktonte në 6 anëtarë numrin e anëtarëve te Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike koordinohet edhe me njësi të tjera administrative dhe akademike për të bërë të mundur ofrimin e programit Bachelor në Sisteme të Informacionit. Njësitë Administrative janë: zyra e Financës, zyra e sekretarisë Mësimore, zyra e Pranimi të Studentëve, zyra e Marketingut dhe Marrëdhënieve me Publikun, zyra e Burimeve Njerëzore, zyra e Menaxhimit të Shërbimeve, zyra e Manaxhimit të Projekteve, zyra e Koordinimit të SUNY/ESC, zyra e mbështetjes me Teknologji Informacioni, Biblioteka, Zyra e Karrierës dhe Marrëdhënieve me të Diplomuarit (Alumni), Dekani i Studentëve, dhe zyra e Marrëdhënieve me Jashtë.

Këshilli shkencor i programit Bachelor në Sisteme të Informacionit I paraqitur në Tabelën 3, i referohet ne RVB [dok “Miratimi i Rregullores se Programeve Shqip dhe Bordit te Programit Bachelor në Sisteme të Informacionit “].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Referuar dokumentit “Organigrama e universitetit sipas statutit të vitit 2017” Departamenti përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit është Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Ky departament nga vitet akademike 2013-14 deri në 2016-17 ka qënë pjesë e Fakultetit të Drejtësisë, Artit dhe Shkencave dhe që nga viti akademik 2017-18, është pjesë e Fakultetit të Informatikës.

- Të dhëna për Stafin akademik

Tabelat 1, 2, 3 në Aneks, paraqesin personelin akademik (PAE dhe PAK) sipas njësive bazë të Fakultetit që ofron programin e studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit. Në këto tabela reflektohen edhe ndryshimet ndër vite akademike në emërtimin dhe strukturën e Fakultetit. Janë paraqitur vitet në të cilat ka qenë aktiv programi i studimit.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Struktura përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit, siç e përmendëm më lart, është Fakulteti i Informatikës dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Për realizimin e programit të studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit janë angazhuar personel akademik, i cili përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë (PAE), personel akademik me kontrate me kohë të pjeshme (PAK) si dhe staf ndihmës mësimor-shkencor .

UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik [dok "Faculty Selection Criteria and Procedures"]. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës [dok "Shembuj Kontrate të Stafit Akademik"]. Institucioni ka bërë përpjekje konkrete për shtimin e stafit akademik me kohë të plotë, numri i personelit akademik me kohë të plotë në Departamentin e Shkencave Kompjuterike është 7.

Në zyrën e burimeve njerëzore gjatë takimit u verifikuan në mënyrë rastësore një dosje të stafit akademik të brendshëm dhe dy dosje të stafit akademik të jashtëm. Dosjet përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

- a) diplomimi përkatës;
- b) formimi i përgjithshëm arsimor dhe profesional;
- c) kualifikimi pasuniversitar (gradat shkencore ose titujt akademikë);
- d) përvoja pedagogjike;
- e) zotërimi i aftësive të nevojshme personale për vendin e punës.

Takimi me stafin akademik u zhvillua sipas agendës, datë 26.10.2018. I gjithë takimi u organizua mbi bazën e pyetjeve dhe diskutimeve rreth metodave të mësimdhënies, menyrës së vlerësimit të studenteve, menyrës së rekrutimit të tyre si dhe procedurave së sigurimit të cilësisë.

Detyrimi për të mbuluar ngarkesën mësimore me minimumi 70% e saj me personel akademik efektive plotësohet.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, është paraqitur në Tabelat 4 në Aneks.
 - Viti Akademik 2013 – 2014 raporti PAE/PAK është 4/6
 - Viti Akademik 2014 – 2015 raporti PAE/PAK është 7/2
 - Viti Akademik 2015 – 2016 raporti PAE/PAK është 8/1

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre .

Të dhënat sipas kualifikimit të stafit jepen në Tabelën 5.

Nga të dhënat e tabelës 5 vihet re një rritje të stafit akademik efektiv nga viti 2013-2014 tek viti akademik 2015-2016 , vite në të cilat programi i studimit ka qënë aktiv. Referuar kualifikimeve të stafit , në vitin e parë kemi të angazhuar një PAE me titull Profesor , dy me gradën shkencore Doktor dhe një asistent me master, ndërsa nga 6 PAK janë pa tituj dhe grada. Në vitin e tretë ku ngarkesa pothuajse mbulohet nga PAE, është shtuar një pedagog me gradën Doktor , dy në proces doktore dhe një me master, ndërkohe që kemi vetem një PAK me titull Prof.Asoc. Përpjekja për të rritur stafin dhe kualifikimet e tij në këtë program studimi , vihet re në të tre vitet aktive të tij.

- Të dhënat sipas seksit, Të dhëna sipas moshës së personelit .

Nga të dhënat e Tabelës 6 vihet re një përpjekje për të rritur numrin e stafit akademik të ri (mosha 25-35) si dhe kualifikimet e tyre (PhD) në të tre vitet aktive të programit të studimit. Bazuar në të dhënat e tabelës 6 rezultojnë që nga 1 PAE në vitin e parë në moshën me pak 35vjet , në vitin e tretë janë 2 me PhD, 2 me doktoraturë në proces dhe dy me master.

- Kontratave të punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

I gjithë personeli akademik efektiv në UNYT është i pajisur me kontrata të rregullta punësimi në përputhje me kodin e punës të Republikës së Shqipërisë. Departamenti i Burimeve Njerëzore, është zyra e mbajtjes së kontratave të punës dhe dosjeve të punësimit.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

UNYT angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente rekrutimi të personelit akademik . [dok” Faculty Selection Criteria and Procedures”].</p> <p>Nga të dhënat e marra nga Tabela 10 , rezultojnë se, nga 1335 orë në auditor që janë realizuar në total për këtë program studimi, 945 orë janë realizuar nga personeli akademik me kohë të plotë</p>

<p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>(PAE).</p> <p>Referuar Tablea 13 , raportet PAE/PAK sipas ngarkesës që mbulojnë në planin mësimor janë :</p> <p>Viti i I (2013-2014): 135 orë PAE/450 orë total pra 30%</p> <p>Viti i II (2013-2014): 360 orë PAE/450 orë total pra 80%;</p> <p>Viti i III (2013-2014): mbulohet 100% nga PAE.</p> <p>Ne total: 70 % te ngarkeses sipas planit mesimor mbulohet nga PAE</p> <p>Personeli akademik vlerësohet nga studentët [dok “Students Evaluation Form”], dhe nga kolegët [dok” Peer Evaluation of Teaching Form”]. Ka edhe forma të tjera të vlerësimit të stafit akademik, të aplikuara në UNYT [dok” Politika te Vleresimit Akademik te Stafit e Mesimdhënies”].</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,</p>	<p>Në Zyrën e Burimeve Njerëzore gjenden të dhëna të hollësishme për anëtarët e personelit akademik, ndihmës, dhe administrative. Ka një listë të plotë të personelit akademik me lëndët përkatëse sipas semestrave.</p> <p>UNYT ka procedura transparente dhe të qarta për rekrutimin e personelit akademik.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit, titullarët e lëndëve janë personel akademik efektiv dhe jo të gjithë kanë gradën shkencore “Doktor”</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>UNYT ka angazhuar personel ndihmës mësimor-shkencor në realizimin e programit.</p> <p>Plani mësimor i licencuar e programit Bachelor në Sisteme të Informacionit [dok” Tabela e Organizimit te Programit - Sistemet e Informacionit”] nuk parashikohet praktikë profesionale.</p> <p>Në program ka temë diplome, ku studenti angazhohet në projekt individual dhe punë kërkimore.</p> <p>Koordinatori i programit së bashku me drejtuesin e departamentit miraton pedagogun udhëheqës të temës së diplomës sipas fushës së interesit të studentit, ku është vendosur të jetë të paktën 1 udhëheqës diplome i angazhuar për 6-7 studentë.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>UNYT i ofron stafit programe zhvillimi dhe u përmbahet politikave që kanë për qëllim rritjen profesionale të stafit [dok” Politika e Zhvillimit të Stafit Akademik”], [dok” Rregullore e Programeve Bachelor ne Gjuhen Shqipe, Neni 70-71”]. Ndërsa politikat e promovimit të stafit janë të përshkruara në udhëzuesin</p>

	<p>[dok” Promotion Guidelines”].</p> <p>UNYT organizon seminare trajnimi si “Faculty Development Workshop”, “Teaching in Higher Education”, “Brown Bag Seminar”, “Konferenca Ndërkombëtare Vjetore” [dok” Faculty Development Workshops]. Baza e të dhënave të programeve të studimit të ofruara është pjesë e sistemit të informacionit “Gnomon”, ku përvec programeve të studimit, detajohen edhe lëndët/modulet, pedagogët, oraret, studentët e regjistruar, etj.</p>
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p> <p>UNYT ndjek procedura ligjore dhe të dokumentuara të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</p> <p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik të punësuar me kohë të plotë përbën 70 % të ngarkesës totale në të tre vitet të programit Bachelor në Sisteme të Informacionit.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore mban të gjitha të dhënat e personelit. UNYT angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij, nëpërmjet organizimit të seminareve për rritjen profesionale të personelit.</p>	

4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Godina kryesore e Universitetit ndodhet në "Kodrën e Diellit" dhe është e përbërë nga 7 kate, në të cilën ndodhen salla për leksione, laboratorët mësimor të informatikës, salla për bibliotekën, zyrat për stafin akademik dhe administrative [dok “Dokumenti i kampusit, godinës dhe infrastrukturës”]. Në godinën e dytë ndodhen disa salla për leksione si dhe qendrat kërkimore.

GVJ vizitoi të gjitha ambientet e vëna në dispozicion të këtij program studimi dhe evidentoi se institucioni ka infrastrukturën e nevojshme, për zhvillimin e një procesi normal të mësimdhënies. Ambientet janë të përshtashme për leksione, laboratorë dhe veprimtari të tjera. Infrastruktura dhe sallat janë në përputhje me standartet teknike për mësimdhënie. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti wireless, e disponueshme për të gjithë.

Laboratorët e kompjuterave janë plotësisht në funksion të programit të studimit për nga përbërja e pajisjeve dhe software-ve të tyre.

Biblioteka e është e hapur çdo ditë dhe ka një numër të konsiderueshem të librave, revistave dhe publikimeve të tjera shkencore [dok “Politikat dhe asetet e bibliotekës”]. UNYT ju ofron studentëve të shfrytëzojnë dhe burime nga universitetet partnere të tij si dhe software si Turnitin (turnit.com) për kontroll të plagjaturës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset e fakultetit (Tabela 7)

Infrastruktura dhe mjediset e UNYT për programin Bachelor në Sisteme të Informacionit janë të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</p> <p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e UNYT ka një fond librash të konsiderueshëm që shërbejnë si tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse.</p> <p>Ka një marrëveshje midis McGraw-Hill dhe UNYT. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë të aksesojnë bibliotekën virtuale të McGraw-Hill. [dok” Biblioteka UNYT”].</p> <p>Tekstet mësimore që caktohen në syllabuset e çdo lënde miratohen nga Koordinatorin e Programit dhe drejtuesi i departamentit. Mbi bazën e tyre, hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës. Biblioteka i ka oraret të shpallura dhe në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>UNYT ka infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. [dok ” Evidenca e Infrastrukturës] .</p> <p>Laboratorët e kompjuterave kanë pajisje dhe software me specifikime e mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit.</p> <p>Zyra e IT është përgjegjëse për asistencë teknike në laboratorë [dok “: IT Support Services”].</p> <p>Cdo klasë dhe auditor është i pajisur me kompjuter për pedagogun, si dhe me projektor. Në laboratorët e kompjuterave dhe në ambjentet e tjera të UNYT ka akses në Internet.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Infrastruktura dhe mjediset e UNYT për programin Bachelor në Sisteme të Informacionit janë të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin normal të procesit mësimor. Laboratorët janë të pajisur me kompjutera dhe software të nevojshëm për zhvillimin e gjithë procesit mësimor. Sallat dhe auditoret i plotësojnë standartet dhe kriteret e cilësisë. Biblioteka ka një numër të konsiderueshëm të librave, revistave dhe publikimeve të tjera shkencore. Në laboratorët e kompjuterave dhe në ambjentet e tjera të UNYT ka akses në Internet.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Referuar RVB [fq 30] , Zyra e Financës ne UNYT është e ngarkuar për zbatimin e politikës financiare institucionale.

Universiteti i New York-ut në Tiranë kryen auditime të brendshme dhe të jashtme në baza vjetore. Auditimi i brendshëm [dok “ Internal Finance Auditing Report 2015-2016”] kryhet nga Komisioni i emëruar nga bordi i akzionerëve të Universitetit, ndërsa auditimi i jashtëm kryhet nga një kompani e pavarur auditimi që kryen veprimtarinë e saj në Shqipëri .[RVB, fq 31]

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit

Tabela 8 detajon të ardhurat në lekë për vitet akademike që programi ka qenë aktiv. Të dhënat tregojnë për mundësitë financiare të Institucionit për të përballuar procesin mësimor në programin e studimit Bachelor Sisteme Informacioni.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Në fund të çdo viti akademik, UNYT bën një analizë të koston për të gjitha programet e studimeve:[referuar RVB fq 31]

Kostoja / viti për studentët e programit Bachelor në Sisteme të Informacionit është paraqitur në Tabela 8, ku mesatarisht në një vit kostoja është 3507 euro

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	UNYT është subjekt i auditimit vjetor të brendshëm dhe të jashtëm, të situatës financiare të tij [dok “ Internal Finance Auditing Report 2015-2016”] , [dok “The external auditing report for the financial year 2017”] . Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë financiare te UNYT. [dok” External audit report for RRPP research project 2014-2015”] [dok “ The internal auditing report for academic year 2012-2013”].
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;	UNYT harton raport vjetor mbi koston-efektivitetin e secilit program studimi duke analizuar shpenzimet [dok: “Raporti Vjetor 2017-2018 ”].

<p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UNYT i dokumenton raportet financiare</p> <p>Referuar RVB ,në 6 vitet e fundit UNYT paraqet një diferencë mesatare prej 6% të fitimit. UNYT dëshmon qëndrueshmëri financiare gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB, UNYT vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare, harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. UNYT dëshmo qëndrueshmëri financiare gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit dhe në vazhdim.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në UNYT Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është institucionalizuar si strukturë organizative nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të strukturave të përhershme, përmes Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KoGaSCI) i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë më specifike janë ngritur struktura përkatëse të cilat veprojnë konform kërkesave të Ligjit të arsimit të lartë dhe i kushtojnë një vëmendje të vecantë sigurimit të cilësisë siç theksohet edhe në misionin e tij institucional [dok. Strategic Plan UNYT 2018-2022] UNYT është i përfshirë si partner në projektin Erasmus+: QainAL “Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri”, i cili kishte si fokus të krijontë dhe të mbështeste proceset për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhim efektiv dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxëniet në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Angazhimi në këtë projekt dhe trajnimet i kanë shërbyer institucionit në përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë. UNYT "përpiqet për përsosmëri akademike në mësimdhënie, bursa dhe shërbim, duke synuar respektimin e standardeve më të larta të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimdhënie" në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, fokus – grupeve, raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njëjësive bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të KoGaSCI nga njëësia bazë & sekretaria mësimore. KGSC zgjidhet nga Senati Akademik siç parashikohet në Statutin e UNYT, (neni 28, Statuti i UNYT) me misionin e zhvillimit dhe forcimit të sistemit të cilësisë në UNYT, duke i shërbyer nevojave të komunitetit të universitetit dhe organeve të interesuara që lidhen me cilësinë e institucionit dhe të programeve të studimit që UNYT ofron.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit?

UNYT është i angazhuar për standarde të larta teorike, empirike dhe në mësimdhënie. Për të siguruar këtë, UNYT kryen vlerësimin periodik të personelit akademik nga ana e studentëve. Ky proces koordinohet nga Asistentja e Rektorit në bashkëpunim me Koordinatorën e zyrës së sigurimit të cilësisë.

Realizohen 2 anketime në vit me studentët, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të semestrit të dytë, gjithmonë përpara sezonit të provimeve.

Përgjigjet llogariten dhe rezultatet ndahen me Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit, dekanin e fakultetit dhe Rektoratin, duke ruajtur diskrecion për të shmangur konfliktin e interesit. Rezultatet e vlerësimit përbëjnë bazën e analizës departamentale të performancës dhe sigurimit të cilësisë.

- *Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?*

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë përpunuar dhe nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht. Nga të dhënat e pyetësorëve, nuk vihen re problematika të mëdha lidhur me stafin pedagogjik dhe atë administrativ. Vlerësimet e viteve të treta mbeten më pozitive. Studentët janë më të tërhequr nga lëndët e fushave të tyre përkatëse, sesa nga lëndët e formimit bazë. Një pjesë e konsiderueshme e studentëve shprehen se do ta rekomandonin universitetin, falë eksperiencës së tyre pozitive.

- *Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm?*

Rezultatet e pyetësorit janë diskutuar në nivel njësie bazë duke ruajtur konfidencialitetin dhe janë përcjellur në njësitë kryesore, në NJSBC dhe Rektorat. Në semestrat pasardhës është synuar përmirësimi i çështjeve problemore të mundshme që kanë rezultuar nga zhvillimi i pyetësorëve, si në raport me stafin akademik ashtu edhe në raport me literaturën dhe përmirësimin e shërbimeve universitare në përgjithësi.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Bazuar në raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në gjëndjen e konstatuar gjatë vizitës, UNYT ka politika të qarta të vlerësimit të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Bazuar në RVB dhe në konstatimin gjatë vizitës në institucion, UNYT vazhdimisht përpiqet që të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të të mësuarit. Në ndjekje të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen kontrolleve shumëvjeçare të monitorimit të cilësisë. Personeli akademik i nënshtrohet formave të shumta të vlerësimit. Këto përbëhen nga vlerësimet e studentëve në bazë të kursit për kurs, vlerësimet nga ana e kolegëve, formën e vlerësimit të performancës individuale të fakultetit, si dhe vlerësimin në raportet vjetore mbi mësimdhënien, të nxënit dhe standartet e lidhura me cilësinë e përpiluar nga secili Departamenti në fund të një viti akademik të gjendura sipas dokumentacionit përkatës [dok. Formulari i Vlerësimit të Studentit për Lëndën], [dok. Individual Annual Performance Assessment Form 2017-2018], [dok. Annual Monitoring Report CSD 2017-2018].

Një mënyrë tjetër që siguron cilësinë e mësimdhënies dhe të mësuarit është Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit [dok. Quality Assurance Report on Grading Fairness - CSD Spring 2018], i cili përgatitet nga Drejtuesi i Departamentit në lidhje me komponentët e mësimdhënies dhe të mësuarit dhe nga Drejtuesi i Qendrës Kërkimore në lidhje me cilësinë e prodhimit hulumtues [dok. Sistemi për Vlerësimin e Kërkimit Shkencor - Fakulteti i Informatikës].

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Të dhëna për anëtarët e NJBSC janë paraqitur në Tabelën 9

Bazuar në Statutin e Universitetit, përgjegjësitë e Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë janë të rrisin dhe të zhvillojnë sistemin e cilësisë në përputhje me misionin dhe kërkesat kombëtare të institucionit. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Koordinatori i Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve, Drejtuesit e Departamentit që mbulojnë Programin janë përgjegjës për çështjet e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Çdo vit, Drejtuesi i Departamentit mbledh Raportet e Koordinatorit të Programit, formularët e vetëvlerësimit, të cilat përfshijnë kërkimin shkencor, aplikimin për fonde të brendshme / të jashtme, ngarkesën e mësimdhënies si dhe shërbimet për institucionin në mënyrë që të përgatisnin Raportin Vjetor të Departamentit [dok. Annual Monitoring Report CSD 2017-2018].

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Të gjitha vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e procedurave të vlerësimit të cilat zbatohen në funksion të programit pasqyrohen në Raportin vjetor të Departamentit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Bazuar në raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në gjëndjen e konstatuar gjatë vizitës, UNYT ka politika të qarta të vlerësimit të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime 	<p>Pas shqyrtimit të DVV dhe takimit me përgjegjësen e NJSBC gjatë vizitës GVJ konstaton se, UNYT përdor metodologji vlerësimi për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit, dekanateve dhe njësisive bazë të fakulteteve.</p> <p>Njëherazi rekomandon detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ana e strukturave dhe vetë NJSBC. Informacioni i përfutur, e që menaxhohet nga NJSBC, bëhet pjesë edhe e raporteve të vetëvlerësimit, pjesë e të cilëve është edhe RVB i programit të studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Për çdo Departament hartohet raporti vjetor i monitorimit në të cilin jepet në mënyrë të detajuar edhe plani i veprimit të njësisë. Gjithashtu për çdo lëndë të zhvilluar bëhet vlerësimi i mësimdhënësit duke llogaritur në këtë mënyrë indeksin e performancës.</p> <p>GVJ konstaton se në institucionin UNYT ndërmjet NJSBC dhe njësisive bazë kryen në mënyrë të rregullt vlerësimi i veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të ndryshme, si vlerësimeve kolegu-për-kolegun, raporteve semestrale për saktësinë, transparencën, audibilitetin e</p>

<p>për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>vlerësimeve të studentëve nga pedagogët, raportet fund-vjetore për ecurinë e vitit akademik</p> <p>Rezultatet e tyre vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe gjejnë reflektimin e tyre në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit u transmetohen pedagogëve në trajtën e një përpunimi statistikor.</p> <p>Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në UNYT kalueshmëria për lëndë dhe pedagogë, etj.</p>
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</p> <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Në kuadër të plotësimit të standardeve institucionale UNYT është akreditua tërësisht në vitin 2006, dhe riakredituar në vitin 2015.</p> <p>Universiteti i UNYT është rikredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 102, date 10.11.2017, në kuadrin e bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar (QAA). UNYT përdorë instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Manuali i Sigurimit të Cilësisë është instrumentë institucional i cili është dokumenti bazë për Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit.</p> <p>Ky proces sigurohet nëpërmjet instrumentave si; Peticionit Akademik, vlerësimit të studentëve, (për pedagogët), raportet e vetëvlerësimit, vlerësimi i pedagogëve nga supervisorët për secilin pedagog.</p> <p>Bazuar në këtë procedurë ekziston një marrëdhënie e ndërlidhur midis pedagogëve dhe supervisorëve në mënyrë që të sigurohet kontrolli dhe balancimi i instrumenteve të sigurimit të cilësisë në UNYT. Manuali i Sigurimit të Sigurisë siguront të gjitha procedurat dhe informatat / modelet e formularëve të vlerësimit të aplikuar në nivel institucional siç janë; Formulari i Performancës së Vlerësimit Individual, Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit, Formulari i vlerësimit të studentëve, Raporti Vjetor i Departamentit, Formularë të vlerësimeve të kolegëve, i Vetë-Vlerësimit etj.</p> <p>UNYT përdorë mekanizma për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve studimore, sic janë rishikimi i planit mësimor nga kreu i departamenteve dhe dekanëve për semestër, dhe në bazë të zhvillimeve të institucionit, kërkesave ligjore dhe nevojave të tregut ekziston një rishikim periodik i kurrikulës i cili miratohej nga Senati.</p>

Studentët në të gjitha nivelet e vendimmarrjes kane përfaqësuesit e tyre, në Senat [dok. Aneksi 5.2: Strategic Plan UNYT 2018-2022].

Konkluzione të GVJ:

Bazuar në raportin e vetë vlerësimit dhe vizitës në institucion rezulton se, në UNYT sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti, analizohen programet mësimore, literatura, sisteme të vlerësimit, para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij.

Nga ana e GVJ u konstatua se në fakulte janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standartet përkatëse.

GVJ dëshiron të vërë në dukje se nga bisedat me drejtuesin e departamentit dhe me stafin akademik në tërësi, u evidentua dëshira institucionale për nevojën e përpunimit të vazhduar të proceseve të garantimit të cilësisë.

Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive të institucionit ndaj menaxhimit të cilësisë tani dhe në të ardhmen.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit është hapur në vitin 2013, i liçencuar me Urdhër të Ministrit Nr. 268, datë 28.06.2013 “Për hapjen e programeve të reja të të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë”, “Administrim Biznesi”, “Sisteme të Informacionit”, të Universitetit privat “Universiteti i New York-ut në Tiranë (New York University of Tirana)” [dok. Urdher i MASH per Licensimin e Programeve Shqip 2013]. Organizimi i programit u modelua sipas programeve 3 vjecare Bachelor që ofrohen në Shqipëri dhe u hartua një rregullore e posacme, e cila përcakton organizimin e programeve Bachelor të UNYT në gjuhën shqipe [dok. Rregullore e Programeve Bachelor ne Gjuhen Shqipe]. Sipas Nenit 40 rregullores, gjuha e mësimdhënies është shqip dhe programi realizohet me jo më pak se 180 kredite dhe me kohezgjatje normale 3 vjet. Të dhëna më të detajuara të organizimit të programit jepen tek pjesa e treguesve të matshëm, dhe janë kryesisht të bazuara në rregulloren e programit.

Përmbajtja e plotë e programit të studimit jepet në Tabelën 10 .

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimeve Bachelor në Sisteme të Informacionit është licencuar në vitin 2013 dhe ka regjistruar vetem 8 studentë në vitin akademik 2013-2014, në vitet akademike në vazhdim nuk është regjistruar asnjë student.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Planet mësimore, ku të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor i programit të studimit i ndarë sipas kategorive formuese jepet në Tabelën 11.

Shpërndarja e krediteve sipas disiplinave është si më poshtë:

1. Disiplinat e formimit të përgjithshëm plotësojnë 18 ECTS ose 10% të programit të përgjithshëm.
2. Disiplina të formimit karakterizues plotësojnë 90 ECTS ose 50% të programit formues.
3. Disiplinat formuese të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese plotësojnë 36 ECTS ose 20% të programit formues.
4. Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët plotësojnë 24 ECTS ose 13.3% të programit.
5. Disiplinat e veprimtarisë formuese, për gjuhë, informatikë dhe praktika plotësojnë 0 ECTS ose 0% të programit të formimit.
6. Provimi i diplomës plotëson 12 ECTS ose 6.6 % të strukturës Bachelor.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Bazuar në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës konstatohet se ndarja e orëve të auditorit sipas veprimtarive të ndryshme (leksion, seminar, laborator, etj), për secilën lëndë, nuk është parashikuar në hartimin e kurrikulës së programit Bachelor në Sisteme të Informacionit. Gjithashtu, kjo ndarje nuk është raportuar nga pedagogët e lëndëve në sylabuset dhe ky atribut u lihet pedagogëve përkatës.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (1 ECTS) për format e studimit:

- 7.5 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit, për lëndët që i përkasin tipeve të veprimtarisë A, B, C, dhe D
- 2.5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit, për lëndët që i përkasin tipit të veprimtarisë F (Teza e Diplomës)

Rezulton se 1 (një) kredit ECTS është 22.5 orë dhe jo 25 orë sipas akteve ligjore.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Institucioni ka paraqitur një sërë ndryshimesh në planin mesimor të miratuar në hapjen e programit të studimit:

- Janë zhvendosur 7(shtatë) lëndë nga një semestër të një viti akademik në një semestër të një viti akademik tjetër.
- Janë hequr 2 lëndë – “Menaxhim i Njohurisë” dhe “Lëndë me Zgjedhje IV”

- Janë pershtatur emërtimet e lëndëve të planit mësimor të cilat janë pershtatje të emërtimeve të lëndëve nga gjuha angleze në shqipe, të cilat nuk konsiderohen si ndryshime thelbësore të planit mësimor.

Në përfundim nuk ka ndryshime rrënjësore të cilat kanë çënuar objektivat e programit të studimi.

Nuk ka ndryshime të syllabuseve të lëndëve. Përshtatja e emërtimeve të lëndëve jepet në Tabelën 12.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lidhja e lëndëve të planit mësimor me personelin akademik përkatës jepet në Tabelën 13, Për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 nuk janë dhënë, pasi në këto vite nuk është regjistruar në Sekretarinë Mësimore për lëndët përsëritëse asnjë nga 2 studentët që kanë vazhduar të jenë në program. Si rrjedhojë, në këto dy vite akademike nuk është ofruar asnjë nga lëndët e programit Bachelor në Sisteme të Informacionit.

Kryesisht programi studimit në vitet kur ka qenë aktiv është mbështetur nga një staf i kualifikuar dhe mjaft cilësor, me eksperiencë dhe kualifikime të mjaftueshme në fushën e caktuar. Mungesa e praktikës profesionale në planin mësimor është mbuluar me punimin e zgjeruar të temës së diplomës.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Përmbajtja e syllabuseve është e plotë dhe bashkohore për një program të tillë, por rekomandojmë që ndarja në kredite të jetë e qartë për çdo formë të mësimdhënies. Ndarja e 6 krediteve në çdo lëndë është në 45 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur. Mendojmë se 45 orë duhet të jenë të ndara qartë sa i takojnë ushtrimeve, sa laboratorëve dhe sa detyrës së kursit. Ndarja në kredite sipas të gjitha formave të mësimdhënies do të japë një pamje më të qartë të peshës që zë gjithë secila dhe do t'i japë më shumë vlera aspektit praktik dhe profesional.

Gjithashtu, mendojmë se sasia e orëve totale në një vit akademik është e vogël, krahasuar me numrin minimal të orëve 600 orë mësimore në auditor, sipas Udhëzimit 15 të MASH/2008;

Analiza e cilësisë së syllabuseve

Drejtuesi i departamentit dhe koordinatori i programit e miratojnë versionin përfundimtar të syllabusit të cdo lënde para fillimit të vitit akademik, pas një vlerësimi të cilësisë së tyre. Këtu kontrollohet konformiteti me modelin e përdorur të syllabusit, prezenca e informacioneve bazë, saktësia e informacioneve, si dhe përditësimi me zhvillimet më të fundit të teknologjisë. Vlerësimi i cilësisë së syllabuseve gjithashtu

komplementohet nga procesi “peer evaluation” i aplikuar në nivel departamenti (dhe prej krijimit të Fakultetit të Informatikës, në nivel fakulteti), ku kolegët vlerësojnë cilësinë e materialeve (përfshi syllabuset) të lëndëve të njëri tjetrit, sic u përshkrua në Rubrikën 6: Sistemi Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i Bachelor në Sisteme të Informacionit që përfundon me diplomën Bachelor ofrohet i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Për të tre vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë 180 kredite që të diplomohet.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Njësia bazë (departamenti) jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimeve, në fillim të çdo viti akademik, nëpërmjet sekretarisë mësimore, me asistencën e asistentëve të tij dhe zyrës së zhvillimit të karrierës.</p> <p>Departamenti jep informacion të nevojshëm për lëndët me zgjedhje dhe ato të detyruara.</p> <p>Departamenti jep informacion të nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe frekuentimin e programit.</p> <p>Syllabuset e të gjitha lëndëve u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik.</p> <p>Pedagogët përgjigjës për zhvillimin e lëndëve kanë atribut të bëjnë ndarjen në leksione, seminare, laboratorë dhe praktika, detyrimet që lidhen me frekuentimin dhe detyrime të tjera që lidhen me shlyerjen e lëndës sipas programit përkatës.</p>
<u>Konkluzionet e GVJ:</u>	
<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e UNYT për zhvillim duke ju përshtatur kërkesave të tregut të punës për specialistë të kualifikuar në këto fusha. Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën shqipe duke përgatitur në këtë mënyrë specialistë të aftë për tregun kombëtar të punësimit.</p> <p>Realizimi i programit mbështetet nga një staf akademik i motivuar dhe me nivel të lartë shkencor. Studentët disponojnë gjithë informacionin për programin e studimit. Departamenti, sekretaria mësimore dhe asistencë e universitetit u vjen gjithmonë në ndihmë për çdo pyetje që këta të fundit ngrenë për programin e studimit, apo çështje të tjera akademike të lidhura më këtë të fundit.</p> <p>Rezulton se 1 (një) kredit ECTS është 22.5 orë dhe jo 25 orë sipas Ligjit të Arsimit të Lartë.</p> <p>Gjithashtu, mendojmë se sasia e orëve totale në një vit akademik është e vogël, krahasuar me numrin minimal të orëve 600 orë mësimore në auditor, sipas Udhëzimit 15 të MASH/2008;</p> <p>Nëse programi i studimit mendohet ri-aktivizohet, rekomandohet rishikimi i planit mësimor me qëllim:</p>	

përcaktimin e orëve për kredit sipas Procesit të Bolonjës, ndarjen e qartë të orëve në auditor në format e mësimdhënies: leksione, seminare, laborator etj. Ndarja në kredite sipas të gjitha formave të mësimdhënies do të japë një pamje më të qartë të peshës që zë gjithë secila dhe do ti japë më shumë vlera aspektit praktik dhe profesional.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Procesi mësimor është i organizuar në minimumi tre vite akademike, koha maksimale e studimeve është 6 vite. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 8 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor/javë. Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati. Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kursi, praktikat profesionale. Numri total i veprimtarive formuese është 30, ku janë parashikuar 29 provime dhe provimi i diplomës. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje, njësoj të rëndësishme. Lëndët janë të gjitha semestrare. Çdo lëndë zhvillohet 3 orë në javë në bllok sipas orarit që afishohet në nivel institucioni dhe në sylabuse. Të gjithë këta elementë formojnë së bashku një program të plotë që synon të ndihmojë studentët të fitojnë një numër aftësish specifike dhe të transferueshme. Ndjekja e rregullt e lëndëve është e detyrueshme, minimumi i pjesëmarrjes në auditor është 80% per secilën lëndë [dok: Rregullore e Programeve Bachelor ne Gjuhen Shqipe, Neni 49]. Studentët të cilët nuk e përbushin minimumin e kërkuar të pjesëmarrjes nuk do e kalojnë lëndën. Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur, të ndërtuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë të balancuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Sic u përmend edhe me sipër, plani mësimor nuk parashikon ndarje të orëve në auditor sipas veprimtarive të ndryshme (leksion, seminar, laborator, etj), kjo nuk është parashikuar në hartimin e kurrikulës së programit Bachelor në Sisteme të Informacionit as në rregulloren e programit, apo në ndonjë dokument tjetër institucional, por lihet në gjykimin e pedagogut në varësi të natyrës së lëndës. Numri total i orëve referuar RVB-së jepet në Tabelën 14.

Format e kontrollit të njohurive

- Kontrolli i dijes së një lëndë bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes është i përcaktuar në Nenin 51 të rregullores së studimit.
- Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato fakultative; zgjedhja e lëndëve fakultative është në pëlqimin e studentit.

- Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit dhe punëve laboratorike.
- Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara.
- Në rregulloren e çdo programi studimi përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive, të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.
- Modulet, provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e moduleve dhe të provimeve shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sesionit.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë et.j. jepet në Tabela 16.

Tabela 16 paraqet aktivizimin e studentëve në aktivitetin shkencor të IAL, nëpërmjet temave të diplomës. Për shkak të numrit të vogël të tyre, edhe numri i temave të diplomës që janë përfunduar është relativisht i vogël.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Programi i studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit ka pranuar për herë të parë studentë të rinj në vitin akademik 2013-2014, me 8 studentë të regjistruar. Aktualisht 3 prej studentëve të programit i kanë plotësuar kriteret për diplomim, 3 të tjerë janë cregjistruar formalisht nga programi, dhe 2 të tjerë ende nuk i kanë plotësuar të gjitha kriteret për diplomim dhe zyrtarisht vazhdojnë të jenë studentë të këtij programi.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

UNYT ka në strukturën e vet Zyrën e Pranimeve (“Admissions Office”), e cila sigurohet për ndjekjen e procedurave të duhura për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj. Procedurat aktuale të pranimit të studentëve të rinj në programet bachelor janë të përshkruara në rregulloren e Zyrës së Pranimeve, pika 4 [Aneksi 18.1: Admissions Office Rules & Regulations]. Ato përmblihen me hapat e mëposhtëm:

1. Para-aplikimet për regjistrim në programet e ciklit të parë të studimeve në universitetin tonë janë të mundura në çdo kohë të vitit akademik.
2. Aplikantët mund të aplikojnë nëpërmjet ueb-it, e-mail-it, telefonit ose duke vizituar ambientet tona ose/edhe sipas përcaktimeve në ligjet përkatëse.
3. Zyra e pranimeve (ZP) kontrollon kualifikueshmërinë e aplikantit bazuar në kriteret e pranimit të përcaktuara me vendimin përkatës të Rektoratit.

4. Zyra e pranimeve (ZP) njofton aplikantin duke përdorur informacionin e tij / saj të kontaktit për para-pranimin; dhe nëse aplikanti është pranuar për regjistrim i bëhet e ditur lista e dokumenteve të nevojshme të regjistrimit.
5. Zyra e pranimeve (ZP) kontrollon listën e dokumenteve të dorëzuara nga kandidati për vlefshmërinë.
6. Zyra e pranimeve (ZP) dërgon dosjen e kompletuar në Komisionin e Pranimin për miratim dhe pastaj dosjet transferohen në Zyrën e Regjistrimit
7. Në rast se kandidati nuk ka një rezultat të suksesshëm në gjuhën angleze, në bazë të direktivës së Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë, kandidati drejtohet për regjistrim në lëndën ESL

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 17)

Cilësia në hyrje e studentëve sipas viteve të regjistrimit paraqitet në Tabelën 17. Në përmbledhje, ka patur regjistrime studentësh të rinj (8) në këtë program vetëm për vitin akademik 2013-2014. Në vitet akademike që pasuan nuk pati më asnjë student të regjistruar në këtë program studimi.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Nota mesatare e studentëve në hyrje ka qënë 7.75, e cila është mesatarja e shkollës së mesme. Studentë të regjistruar në vitin e parë në vitin akademik aktual nuk ka, institucioni mendon të kalojë procedurën e akreditimit dhe më pas të rihap thirrjen për këtë program studimi.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Në vitin 2016 kanë qënë vetëm 3 studentë të diplomuar me notë mesatare 6.14, 3 studentët e tjerë janë cregjistruar dhe 2 studentë mbetën debitor në plotësimin e numrit 180 kredite të domosdoshme për diplomim, të dhënat janë përmbledhur në Tabelën 17a.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk ka pasur studentë të transferuar në këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve është berë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>UNYT ka edhe kriteret e tij të veçanta, të specifikuar në [dok: Kriteret e Pranimin 2017-2018]. Gjithashtu, me vendim senati të datës 12/01/2017 [dok Vendim 32 i Senatit per Kriteret e Pranimin 2017-2018], është vendosur si kriter shtesë për pranimin në programet Bachelor, nota mesatare në hyrje mbi 6.5.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të rregullt dhe në detaje në lidhje me programin e studimit. Akeses i infomacionit është si</p>

<p>e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Guida stutentore • Web site zyrtar i UNYT www.unyt.edu.al) • Zyra e karrieres • Pedagogët e moduleve. <p>Prej vitit akademik 2015-2016, për shkak të numrit të ulët të studentëve të regjistruar deri në atë kohë, ishte vendosur që programet e studimit Bachelor në gjuhën shqipe të mos ofrohen më, dhe për këtë arsye ato nuk janë reklamuar më në ueb site apo nëpërmjet formave të tjera të informimit.</p> <p>Studentët vlerësojnë pedagogun e cdo lënde në përfundim të semestrit. Kriteri i vlerësimit të pedagogëve bëhet mbi bazën e mësimdhënies komunikimit dhe etikes profesionale, gjithashtu edhe departamenti bën një vlrerësim të brendshëm të pedagogëve.</p> <p>Zyra e karrierës u ofron këshillim për karrierë dhe mundësi punësimi ndërmjet marrëveshjeve bashkëpunuese që UNYT ka me kompanitë e tregut dhe lidhjeve me Panairin e Punës.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>UNYT disponon statistika për numrin e të diplomuarve dhe studentëve që pritet të diplomohen.</p> <p>UNYT ka statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërhequr dhe larguar para përfundimit të programit dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Nga verifikimet e kryera në sekretarinë mësimore në mënyrë të rastësishme dosjet e studentëve të rregjistruar,apo që kanë ndëprerë studimet në mënyrë të njëanshme rezultuan të rregullta.</p> <p>UNYT disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e në vazhdim.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor. UNYT i cakton secilit student një këshillues akademik (“academic advisor”). Ky këshillues është anëtar i stafit akademik, zakonisht i njësisë bazë që ofron programin, i cili e ndjek progresin akademik të studentit gjatë semestrave dhe e këshillon atë në lidhje me ecurinë akademike dhe profesionale [dok. Duties of Advisors].</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Sisteme të Informacionit nuk parashikon praktikë profesionale, pra nuk ka patur këshillim për përzgjedhjen e institucionit ku zhvillohet kjo praktikë.</p>

Konkluzionet e GVJ

UNYT i informon studentët për procedurat e akreditimit të institucionit, të programeve të studimit, për procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit.

UNYT në strukturën e tij organizative ka Zyrën e Karrierës. Ky organizim punon për të realizuar këshillimin për karrierë dhe për të mbajtur lidhjet e institucionit me të diplomuarit. Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor, praktikën dhe kërkimin.

UNYT duhet të punojë më shumë në përthithjen e studentëve të rinj me rezultate të larta, pasi kjo do të rriste edhe nivelin e brendshëm të vetë studentëve të tjerë.

UNYT duhet të intensifikojë kontaktet në vendosjen e bashkëpunimeve edhe me kompani të mëdha të Teknologjisë së Informacionit në Shqipëri, si kompanitë mobile, kompanitë e Internetit etj, në mënyrë që studentët të integrohen në fusha edhe më të gjera të mundshme në tregun e vështirë e konkurrues të punës.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Bazuar në materialet e dosjes DVB [dok. UNYT Research Strategy 2014-2017], UNYT synon në rritjen e kapaciteteve dhe intensitetit të kërkimit duke rritur pjesën e stafit akademik të angazhuar në kërkim dhe duke prodhuar publikime të cilësë më të lartë. UNYT mbështet kërkimin shkencor ndërdisiplinor mes të gjithë njësive bazë, departamente e qendra kërkimore dhe në partneritet me institucione të tjera kërkimore. Aktivitetet dhe produktet kërkimore synojnë jo vetëm të rrisin impaktin në shkëmbimin e njohurive në komunitetin shkencor por edhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik social të vendit përmes adresimit të problematikave me zgjidhje kreative e rekomandime të qarta politikash. Në funksion të politikave të kërkimit shkencor, në UNYT, ruajtja e integritetit, barazia dhe diversiteti janë thelbësore mes stafit dhe studentëve të përfshirë në kërkim shkencor.

Fushat prioritare kërkimore janë të përcaktuara në bazë të profilit të institucionit, interesave kërkimore të stafit sikurse edhe prioritetet kërkimore të European Research Area. Në [dok. UNYT Research Pillars 2017], parashtrohen pesë shtyllat kërkimore dhe projektet kërkimore tematike ku stafi dhe studentët janë angazhuar. Universiteti ka intensifikuar përpjekjet për të marrë pjesë në projekte të financuara nga palë të treta dhe nga instrumentat e BE-së [dok. List of Projects & Research Partners].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Fushat e kërkimit të cilat përfshihen në fokusin e Fakultetit të Informatikës janë po ato fusha në të cilat stafi është ngushtësisht i specializuar. Ekspertiza e ngushtë e stafit të Fakultetit të Informatikës konvergjon në këto tre fusha: Sistemet Inteligjente dhe Aplikacionet, Inxhinieria softuerike dhe Sistemet e Informacionit dhe Teoria e Komputacionit. Lëndët bërthamë të kurrikulës siç janë Arkitektura e Kompjuterave, Sistemet Operative, Rrjetet Kompjuterike, Inxhinieri Software, Sistemet e Databazave, Algoritmika, Inxhinieria e

Sigurisë, Sistemet e Informacionit të Menaxhimit, etj., janë gjithmonë të përditësuara me risitë e reja nga zhvillimi shkencor në këto fusha, meqë mbajtësit e këtyre lëndëve janë kërkues aktivë në këto fusha.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL 25

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Nuk ka patur projekte kërkimore të fituara në lidhje me programin e studimit, nga biseda me drejtuesen e zyrës së projekteve na informuan në lidhje me përpjekjet që po bëhen për të fituar projekte që lidhen me universitete në vendet e BE-së.

Numri i projekteve të zbatuara

Projekte të zbatuara si nivel IAL kanë qenë 5.

Numri i aktiviteteve shkencorë të organizuara nga IAL

Universiteti ka organizuar tre konferenca, dy konferenca ndërkombëtare dhe një kombëtare si më poshtë:

- “Transition in Retrospect: Twenty Five Years after the Fall of Communism”, Tirana, Nëntor 27-28, 2015.
- “International Conference on Labor Migration and Industrial Citizenship”, Tirana, Nëntor 13, 2015.
- “First National Student Conference”, Tirana, Maj 27, 2016.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL jepet ne Tabelën 18

Sic shihet edhe në tabele ka një numër të konsiderueshëm të aktivitetit shkencor nga ana stafit akademik, vetëm në vitin e fundit akademik 2017-2018 kemi një numër prej 25.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Kërkimi shkencor është fokusuar në punë individuale të pedagogëve në këto drejtime kryesore:

- Kualifikimin e pedagogëve të brendshëm për marrjen e gradës Dr. në fushën e inxhinierive.
- Përgatitjen e teksteve bazë, për të siguruar cilësi më të lartë;
- Studime dhe botime në revista shkencore brenda e jashtë vendit.
- Pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Tre studentët që kanë përfunduar punimin e diplomës janë përfshirë në aktivitet shkencor. Studentët e programit Bachelor në Sisteme të Informacionit janë orientuar që kërkimin shkencor të tyre ta zhvillojnë në funksion të Inxhinierisë Softuerike dhe Sistemeve të Informacionit, kryesisht si pjesë e temës së tyre të diplomës. Qëllimi ka qenë përputhja mes kërkimit shkencor në programin e studimit dhe shtyllave kërkimore të UNYT. Më poshtë listohen temat e diplomës që janë përfunduar me sukses nga studentët e programit [dok. Udheheqja e Temave të Diplomes 2015-2016]:

- “Smart Learning System ne UNYT”
- “Sistem Online per Blerjen dhe Porositjen e Librave”
- “Ndertimi i nje Aplikacioni Web per Menaxhimin e Produkteve te nje Dyqani”

Numri i Çmimeve Kombëtare

Cmime kombetare te fituara nga IAL ka qene 2, ICT Awards për Academic of the Year në vitin 2013 dhe 2016.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe mobiliteti në UNYT menaxhoheshen nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (“International Relations Office”), kurse lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës menaxhohen nga Zyra e Karrierës dhe Alumni. Studentët e programit Bachelor në Sisteme të Informacionit, si të gjithë studentët e UNYT, kanë akses në aktivitetet, shërbimet dhe mundësitë që ka ofruar UNYT nëpërmjet këtyre zyrave.

Zyra e Karrierës dhe Alumni mban lidhje të forta me komunitetin e biznesit, i cili vjen në UNYT për prezantime, leksione të hapura, seanca rekrutimi si edhe për panairin e përvitshëm të punësimit (“Career Fair”) që UNYT organizon çdo vit.

Zyra e e Marrëdhënieve Ndërkombëtare u themelua duke patur parasysh se: “krijimi, zhvillimi, përcjellja dhe mbrojtja e dijeve, si edhe përgatitja e qytetarëve paraprirës të së ardhmes” (nga Misioni i UNYT) kërkon zhvendosjen e burimeve dhe asetëve intelektuale nga një kontekst lokal në kontekstin global. Kjo zyrë udhëhiqet nga Strategjia e Ndërkombëtarizimit e UNYT [dok. Internationalization Policy 2016-2021].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar jepen në Tabelën 19 .

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar në nivel institucional është mjaft i bollshëm, kjo edhe për faktin e mënyrës së veprimit të UNYT, megjithatë për programin e studimit në fjalë nuk mund të gjykojmë se sa ka qënë përfitues edhe për faktin se ky program studimi është ofruar në gjuhën shqipe edhe bashkëpunimi kombëtar me institucione në vënd, në këtë fushë nuk ka patur.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
 - Organizatat Profesionale
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Ka një marrëdhënie të bollshme me kompani shqiptare të tregut, ku studentët mund kryejnë praktikat mësimore dhe kanë mundësi punësimi pas diplomimit, një liste e plotë jepet në Tabelën 20.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
